



HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A

Nr. I/56

Datë: 19.04.2024

Bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. I/53, të datës 27.03.2024, për formimin e Komisionit për Seleksionimin e Kandidatëve në Konkursin e datës 15.03.2024 për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit, duke pasur parasysh kushtet dhe kriteret e kualifikimit të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe në Konkursin e datës 15.03.2024, Komisioni për Seleksionimin e Kandidatëve, pas shqyrtimit të aplikacioneve në këtë Konkurs, njëzëri mori këtë:

VENDIM

- I. Për krijimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e kualifikimit për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit sipas Konkursit të datës 15.03.2024:
 1. **Besarta Rrahmani;**
 2. **Burim Bylygbashi;**
 3. **Xhevdet Leci.**
- II. Të gjithë kandidatët, në listën si më lart, i propozohen Bordit të Drejtorëve për intervistim për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit sipas Konkursit të datës 15.03.2024.

Arsyetim

Brenda afatit sa konkursi ka qenë i hapur, 15 mars deri më 15 prill 2024, kanë aplikuar gjithsej tetë (8) persona, gjashtë (6) prej tyre përmes postës elektronike dhe dy (2) tjerë kanë dorëzuar dokumentacionin fizik në arkivin e Ndërmarrjes. Duke pasur parasysh kushtet dhe kriteret ligjore, të cilat është kërkuar që të plotësohen nga kandidatët në Konkursin për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit, të publikuar më 15.03.2024, Komisioni pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të aplikantëve në këtë Konkurs, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kandidatët për pozitën e ZKFTH-së, si në tabelën më lart, janë radhitur në bazë të alfabetit. Listës si më lart mund t'i shtohen edhe kandidatë tjerë, në rast se ndonjëri prej aplikantëve të refuzuar nga Komisioni vlerësohet në procedurë të ankesave të mundshme nga komisioni përkatës.

Në emër të Komisionit Seleksionues

Luljeta Lutfiu, Kryetare

